



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Nr. 299 Prot.,

Tiranë, më 14 02 .2025

Lënda: Dërgohet raporti për vitin 2024 mbi monitorimin e buxhetit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
Rruga "Dëshmorët e 4 shkurtit", Tiranë

Të nderuar,

Në zbatim të udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "*Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", shtojca 3, po ju paraqesim informacionin narrativ mbi monitorimin e buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2024, për AIDA-n.

1. Hyrje.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe Mënyrën e Funkcionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve" ka për qëllim të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit, promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit.

AIDA deri në përfundim të vitit ushtrimor 2023, ka qenë pjesë e planit buxhetor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Grupi 10. Në fillim të vitit 2024, me hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 17.01.2024 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit" dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.

Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

31, datë 17.01.2024 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive të Ministrisë së Financave", institucioni ynë u klasifikua si pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, grupi 12.

Në vijim, me shkresën e Ministrisë së Financave me nr. 2917/1 prot., datë 12.03.2024, na u komunikua dhe ndryshimi i kodeve të institucionit, duke u shoqëruar me nje proces gati 1 (një) mujor të transferimit të fondeve nga kodi i institucionit si pjesë e Grupit 10 (MF), në kodin e ri të institucionit si pjesë e Grupit 12 (MEKI).

Në zbatim të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023, të sipërcituar, lidhur me raportimin mbi monitorimin e buxhetit 8 mujor, sqarojmë se shpenzimet buxhetore të kryera nga ana jonë për këtë periudhë raportuese janë të ndara në dy grupe buxhetore, konkretisht për periudhën janar – mars 2024, fondet janë akorduar dhe shfrytëzuar si pjesë e Grupit 10 (MFE), ndërsa gjatë muajit prill – gusht 2024, fondet e papërdorura brenda limitit vjetor të miratuar me ligjin nr. 97/2023, janë mbartur dhe shfrytëzuar në Grupin 12 (MEKI).

1. Informacioni buxhetor i agreguar

AIDA, në zbatim të Ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 "Për sistemin e menaxhimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", ligjit nr.10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve"(AIDA), si dhe VKM nr. 846, datë 26.12.2024, gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2024, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga 2(dy) burime:

A. Buxheti i Shtetit në masën **249,423,300 lekë**, ku përkatësisht në masën 195,193,300 lekë për shpenzime korrente lidhur me objektin e veprimtarisë së AIDA-s, konkretisht;

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit;

- Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,

dhe 54,230,000 lekë për shpenzime për investime me kapital të brendshëm.

Fondet në fjalë gjatë periudhës raportuese kanë pësuar këto shtesa dhe pakësime:

- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) me nr. 3499/1 prot., datë 28.03.2024, protokolluar këtu me nr. 506, datë 02.04.2024, "Mbi detajimin e fondit të veçant", është shtuar fondi i llogarisë ekonomike 606 0000 në masën **120,000 lekë**.
- Me shkresën e Ministrisë së Financave me nr. 5662/1 prot., datë 08.05.2024 është miratuar saktësimi i llogarisë ekonomike të fondeve të akorduara në 4 (katër) projektet e investimeve në masën **51,830,000 lekë**, nga llogaria 230 0000 në llogarinë 231 0000.
- Me shkresën e Ministrisë së Financave me nr. 10356/1 prot., datë 07.08.2024, është përcjellë miratimi i rialokimit të fondeve, konkretisht, shtuar llogaria 602 në masën **4,000,000 lekë**, pakësuar llogaritë 600 0000 dhe 601 0000 në masën 2,000,000 lekë/seicila.

- Me shkresën e Ministrisë së Financive me nr. 10001/1 prot., datë 08.08.2024, miratuar ndryshimi i destinacionit të fondit të investimit prej **2,000,000 lekë** në projektin ‘Përmirësim sistemesh’, duke e pakësuar dhe shtuar projektin e ri “Blerje pajisje elektronike AIDA”, në masën **2,000,000 lekë**.
- Me AN nr.3, datë 28.08.2024, shtuar llogaria e shpenzimeve për paga 600 0000 në masën **7,000,000 lekë**, fonde të cilat do shërbenin për stafin e ri të AIDA-s sipas project propozimit për ristrukturimin e AIDA-s.
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 1498 prot., datë 20.09.2024, është përcjellë miratimi i shtimit të fondeve në llogarinë 602 në masën **7,000,000 lekë**.
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 11514/2 prot., datë 30.09.2024, është përcjellë miratimi i rialokimit të fondeve për projektet e mbështetjes financiare brenda llogarinë 231, Konkretisht, projektet për Inovacioni, Start Up dhe Biznesin Kreativ janë pakësuar në masën totale prej **14,000,000 lekë** dhe ky fond ka shkuar për Projektin e Konkureshmërisë.
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 10993/3 prot., datë 29.10.2024 është përcjellë miratimi i rialokimit të fondeve nga fondi i veçant për AIDA-n, konkretisht pakësimi i masës prej **120,000 lekë**, për sa mos përdorur gjatë vitit 2024.
- Me AN nr. 5, datë 19.12.2024, është pakësuar:
 - a) Llogaria 600 (fondi i pagave) në masën **14,000,000 lekë**, pasi për shkak të miratimit në muajin dhjetor 2024 të ndryshimeve në organikën e re të AIDA-s rezultoi e pamundur rekrutimi i stafit të ri;
 - b) Llogaria 604 për mbështetjen me grante të NVM-ve, prej **1,800,000 lekë** (vlera për tu përfituar si grant i një prej NVM-ve që u tërhoq nga zbatimi i marrëveshjes me AIDA-n duke e lënë fondin të papërdorur);
 - c) Llogaria 231 parashikuar për investime me kapital të brendshëm në masën **2,770,000 lekë** për projektin “*TVSH për projektet me financim të huaj*”, e cila lidhet me fondin që përdoret për financimet e huaja ku TVSH rimburohet nga shteti në rast se gjatë zbatimit të aktiviteve gjenerohen shpenzime me këtë përmbajtje;
- Në zbatim të VKM-s nr. 846, date 26.12.2024 "*Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore*", na është shtuar fondi me **33,300 lekë** për dhënien e ndihmës së menjëhershme për 3(tre) punonjësit mbështetës në AIDA.

B. Financim i huaj në masën **8,300,000 lekë** si plan për shpenzime për investime me kapital të jashtëm (projekti Skills for Jobs Albania Montenegro). Gjatë kësaj periudhe raportimi nga donatori është përdorur fondi në masën 2,430,031.75 lekë, ndërkohë për mbajtjen e aktiviteve referuar projektit janë shpenzuar 3,793,163 lekë.

Me AN nr. 5, datë 19.12.2024, është pakësuar në masën **4,500,000 lekë** për projektin “Financim i huaj Skills for jobs Albania Montenegro”, financimi i huaj nga projekti i BE, pasi gjatë zbatimit të projektit kjo shumë e parashikuar për tu arkëtuar nuk gjeti realizim pasi donator nuk arriti të

Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

lëvronte trandhin e radhës brenda vitit 2024, si pasojë AIDA nuk mundi të vijonte me zbatimin e aktiviteve të mbetura. Plani i ndryshuar për këtë zë është prej **3,800,000 lekë**.

Në përfundim të vitit 2024, rezulton se fondi faktik i parashikuar për AIDA-n është në total në masën **253,190,000 lekë**. (249,423,300 lekë financim nga Buxheti Shtetit dhe 3,800,000 lekë Financim i Huaj).

- **Performanca e AIDA-s gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2024**

Gjatë vitit 2024, AIDA ka shënuar rritje në nivel performance, si në aktivitetet përfaqësuese me palë të treta, ashtu edhe në përkrahjen e investitorëve vendas dhe të huaj.

a) Performanca e produktit: “Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit”.

Gjatë vitit 2024, AIDA ndoqi 6 Leads (projekte investimi potencial) të rinj si Lidl, Zuegg, Perutnina Ptuj, Tratos, Insit Group dhe Roncadin. Gjithashtu është riaktivizuar Lead i kompanisë Vischer-Caravelle. AIDA u ka ofruar këtyre kompanive akses në informacione të përditësuara, ka përmirësuar komunikimin me organet qeveritare dhe po identifikon në mënyrë aktive opsionet e përshtatshme të tokës për disa prej tyre.

FUSHATA OUTREACH

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me mbështetjen e Regional Cooperation Council (RCC) dhe World Bank Group (WBG) zhvilloi një fushatë outreach me fokus sektorin e turizmit në Spanjë përgjatë datave 18-20 Qershor 2024.

Në kuadër të tërheqjes së brandeve elitare europiane në tregun vendas, AIDA zhvilloi takime fizike me disa prej grupeve hoteliere më në zë spanjolle, duke përfshirë Barcelo Group, Catalonia Hotels dhe Eurostar Hotels by Groupo Hotusa për të prezantuar ofertën e qeverisë shqiptare, incentivat fiskale të sektorit të turizmit, avantazhet konkurrese të Shqipërisë etj.

Gjatë takimeve u konstatua një interes i lartë për t’u bërë pjesë e tregut shqiptar dhe se vemendja e grupeve hoteliere më të mëdha spanjolle është të zhvillojnë struktura elitare në bregdetin shqiptar, por pa përrjashtuar dhe vendosjen në qytetet më të mëdha në vend që ofrojnë turizëm 12-mujor si Tirana, Durrësi, Vlora etj.

Në përfundim të këtyre takimeve, AIDA zhvilloi gjithashtu një takim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Madrid dhe me Dhomën e Ekonomisë Shqipëri - Spanjë ku krahas diskutimeve mbi interesin e shtuar drejt Shqipërisë si një destinacion për të investuar në sektorin e turizmit dhe jo vetëm, u vlerësua dhe nevoja për një koordinim të shtuar dhe sa më eficient të aktorëve publik dhe privatë në funksion të realizimit të objektivit të përbashkët të fuqizimit të ekonomisë shqiptare.

Në muajin tetor 2024, përfaqësuesi i Eurostar Hotels vizitoi Shqipërinë si edhe realizoi një takim pranë zyrave të AIDA.

FORUME BIZNESI

- Përgjatë 2024 AIDA në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës Çeke në Shqipëri dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, organizuan Forumin e Biznesit Shqipëri – Çeki, si një dëshmi e vullnetit të përbashkët për të thelluar bashkëpunimin ekonomik dhe eksplorimin e mundësive dypalëshe për të nxitur partneritete, si dhe investime të reja. Në përfundim të forumit, u zhvillua dhe sesioni i takimeve B2B, ndërmjet kompanive shqiptare dhe atyre çeke, për të diskutuar mundësi konkrete bashkëpunimi dhe krijimin e partneriteteve në të ardhmen.
- Në muajin Mars 2024, AIDA organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri – Arabi Saudite e cila mbledhi së bashku rreth 50 biznese arabe dhe 50 biznese shqiptare. Forumi u përmbyll me takimet B2B ndërmjet bizneseve të Arabisë Saudite dhe atyre shqiptare, si edhe me takimet B2G me përfaqësues të qeverisë shqiptare.
- Në muajin Shtator 2024, AIDA në bashkëpunim me Greek - Albanian Industrial Commercial and Professional Association organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri - Greqi.
- Në muajin Nëntor 2024, AIDA organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri – Emiratet e Bashkuara Arabe. Delegacioni i Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA), i kryesuar nga Ministri për Tregtinë e Jashtme, Sh.T.Z. Thani Bin Ahmed Al Zeyoudi, përfshiu përfaqësues të kompanive elitare dhe solli mesazhe të qarta për rritjen e investimeve dhe shkëmbimeve tregtare. Eventu përfshiu diskutime strategjike dhe bisedime B2B mes kompanive të fushave si energjia, teknologjia dhe ndërtimi, duke vendosur bazat për projekte të reja. Ndër pjesëmarrësit e delegacionit nga pala e Emirateve të Bashkuara Arabe ishin kompani si Masdar, JAFZA, ADNOC Global Trading, Kumo Industries dhe Oumolat.

FUSHATA AFTERCARE

Gjatë vitit 2024, Sektori Lead dhe Aftercare pranë Drejtorisë së Investimeve të Huaja, Partneritetit dhe Kërkimit në AIDA organizoi 2 fushata të shërbimit të përkujdesjes ndaj investitorit, 2 tryeza të rumbullakëta me kompani të sektorit automotiv dhe turizmit, si dhe ndërmorri nismën “Investor Support Days”. Rrjeti i bashkëpunimit me qeverisjen lokale funksionon aktualisht me 12 bashki të vendit, përkatësisht Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë, Fier, Elbasan, Kavajë, Vorë, Kamëz dhe në 2024 me bashkinë Korçë.

Në muajin Prill 2024 u zhvillua Tryeza e Rumbullakët e Sektorit Automotiv me 6 kompanitë më të njohura e sektorit, duke vijuar më pas me fushatën e dedikuar në sektorin e turizmit me subjektet më në zë të turizmit. Në këtë kuadër u zhvillua dhe Tryeza e Rumbullakët e Sektorit të Turizmit me 15 kompani si dhe me përfaqësinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe bashkive Tiranë, Vlorë, Shkodër, Durrës.

Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

Me bashkëpunimin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit AIDA finalizoi me sukses nismën "Investors Support Days".

Kjo iniciativë u zhvillua përmes takimeve javore me kompanitë gjermane, italiane, turke, greke, franceze, austriake dhe hungareze. AIDA pati përfaqësinë e institucioneve si Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministria e Financave, AKPA, AKBN dhe Korporata Shqiptare e Investimeve. Gjithashtu ambasadat e Gjermanisë, Italisë, Turqisë, Greqisë, Francës, Austrisë dhe Hungarisë si dhe DIHA-s, Dhomës Italiane të Tregtisë, Confindustria, MUSIAD, Shoqata Greke e Biznesit në Shqipëri si dhe Advantage Austria.

Në këtë tryezë morën pjesë një total prej 120 kompanish. Në vijim të problematikave të raportuara janë dërguar dhe po ndiqen me prioritet shkresat dhe korrespondenca elektronike me institucionet e qeverisjes qendrore për 10 kompani.

Përgjatë vitit 2024 AIDA ka takuar 163 kompani përmes vizitave në terren, tryezave të rrumbullakëta, por dhe përmes takimeve të investitorëve të huaj në vendin tonë, duke përmbushur kështu një detyrë të dyfishtë. Ndër të tjera janë asistuar 18 subjekte për problematika të natyrave të ndryshme.

MISIONI I PARË I BIZNESIT - POLONI

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në përmbushje të funksionit të saj si institucioni kyç për tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri dhe forcimin e potencialit eksportues të vendit, në bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën Shqiptare në Poloni dhe PAIH (Polish Trade and Investment Agency), organizoi për herë të parë një mision tregtar në Varshavë, gjatë datave 18 - 19 nëntor 2024. Misioni synonte identifikimin e partnerëve të rinj dhe tregjeve potenciale për kompanitë shqiptare, duke ofruar mundësi konkrete për zhvillim dhe zgjerim ekonomik. Ai u organizua me një fokus të veçantë në sektorët e bimëve medicinale dhe prodhimit të produkteve të kujdesit të lëkurës.

Ky mision dëshmoi potencialin e jashtëzakonshëm për zhvillimin e lidhjeve tregtare dhe investimeve dypalëshe mes Shqipërisë dhe Polonisë, duke hapur horizonte të reja për bashkëpunim ekonomik në sektorë të ndryshëm.

AIDA PJESËMARRËSE NË GRUPIN E PËRBASHKËT TË PUNËS PËR INVESTIME PËR RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mori pjesë në Grupin e Përbashkët të Punës për Investime për Rajonin e Ballkanit Perëndimor, të zhvilluar më 28 Maj 2024. Kjo mbledhje u organizua nga Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit (RCC), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të IPA-ve përkatëse dhe ministrive përgjegjëse për ekonominë të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Takimi u mbajt në Budva dhe u zhvillua në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe Grupin e Bankës Botërore.

Qëllimet kryesore të mbledhjes ishin avancimi i punës për standardet rajonale të screening të investimeve të huaja direkte, prezantimi dhe diskutimi i gjendjes aktuale të inventarëve të incentivave të investimeve dhe materialeve rajonale promovuese të investimeve, si dhe adresimi i çdo sfide të mundshme që lidhet me fushatat outreach. Gjithashtu, takimi kishte për qëllim shqyrtimin e draft masave për CRM-në e re lidhur me investimet.

Në tetor u lançua inventari i incentivave të investimeve nga RCC pas bashkëpunimit me AIDA. <https://www.wbiip.rcc.int/?incentive=&economy%5B%5D=1>

MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT VITI 2024

Përgjatë vitit 2024, AIDA ka nënshkruar 5 memorandime bashkëpunimi me bashki, agjenci homologe dhe partnerë të tjerë, si më poshtë vijon:

- Bashkia Korçë – 2024
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi (ATTSO) - 2024
- Montenegrin Investment Agency (MIA) – 2024
- Hungarian Export Promotion Agency (HEPA) – 2024
- Instituti i Politikave të Qëndrueshme (ISP) - 2024

PROJEKTE TE VLERËSUARA NGA KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE (KIS) PËRGJATË VITIT 2024

VITI	2024
Projekte totale të trajtuara	14
Projekte të miratuara	8
Projekte të refuzuara	6
Shqyrtime të tjera*	4

REZULTATET SI PASOJË E APLIKIMIT TË LEGJISLACIONIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Duke pasur parasysh aplikimin e legjislacionit për investimet strategjike, si dhe shtimin e numrit të investitorëve që kërkojnë aplikimin e masave asistuese apo mbështetëse nga AIDA dhe shteti shqiptar, duhet theksuar se ka një vlerësim tepër pozitiv mbi kuadrin ligjor ekzistues, pavarësisht se në fillimet e zbatimit të tij, investitorët mund të kenë qenë edhe skeptikë me efektivitetin e zbatimit të këtij ligji. Por sot, është fakt se ky legjislacion është liberal, jo diskriminues për

investitorët, qofshin këta vendas apo të huaj, si dhe transparent, në drejtim të incentivave dhe programeve sektoriale, me anë të të cilit janë thjeshtëzuar edhe më tej procedurat administrative.

Tashmë, si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike, projektet e investimit që aplikojnë dhe asistohen nga AIDA kanë më shumë lehtësira në marrjen e lejeve zhvillimore apo lejeve të ndërtimit, kurse masat mbështetëse janë lehtësisht të zbatueshme dhe me procedura të përsheptuara.

Zbatimi i ligjit përgjatë kësaj periudhe ka krijuar një rrjet komunikimi ndërinstitucional shumë funksional. Ligjit të investimeve strategjike Nr.55/2015, i ndryshuar, i ka përfunduar afati i aplikimeve më datë 31.12.2024. Në muajin maj 2024 u vendos shtyrja e vlefshmërisë të tij edhe me një vit. Aktualisht, ky ligj është në proces rishikimi pranë Komisioneve Parlamentare.

NXITJA E EKSPORTEVE DHE RRRITJA E AFTESIVE KOKURRUESE TE NMVM-VE

Indikatorët:

- a) Organizimi dhe pjesëmarrje në 2-3 panaire kombëtare/ndërkombëtare në bashkëpunim me donatorët

- **4 Panaire Ndërkombëtare:**

- Biofach 2024 –13-16 Shkurt 2024, Nuremberg, Gjermani,

6 kompani pjesëmarrëse: 5 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike dhe 1 kompani nga sektori i vajit të ullirit, Kompanitë realizuan 423 kontakte me kompani të huaja, 88 kontrata potenciale për një vlerë potenciale prej 7.565.000 Euro.

- MoMad - 13-15 shtator, në Madrid, Spanjë

4 kompani pjesëmarrëse: 3 kompani nga sektori tekstil dhe dhe 1 kompani nga sektori lëkurë këpucë. Kompanitë realizuan 25 kontakte me kompani të huaja, 10 kontrata.

- GagFestival – 2-3 tetor 2024, Berlin, Gjermani

5 kompani pjesëmarrëse, 3 kompani nga sektori i verës dhe birrës dhe 2 kompani të vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 18 kontakte me kompani të huaja, 10 kontrata.

- FI North – 30-31 tetor 2024, në Las Vegas, SHBA

8 kompani pjesëmarrëse: 6 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike dhe 2 kompani nga sektori i vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 399 kontakte me kompani të huaja, 102 kontrata të mundshme për një vlerë potenciale prej 2.210.000 lekë.

- **3 Panire Kombëtare:**

- Panairi “Ditet e Bujqësisë”- 24-26 prill 2024, Lushnje

AIDA pjesëmarrëse me standë ku promovojë shërbimet që agjencia ofron në mbështetje të NMVM-ve shqiptare.

- “Agro Tech & Natyral Ekspo”- datat 16-18 maj 2024, Farkë,

10 kompani pjesëmarrëse: 3 kompani të produktit mjalti, 2 kompani të produktit djath, 1 kompani e produktit vezë, 2 kompani të verës, 2 kompani nga artizanati.

- Panairi Ndërkombëtar i Tiranës- datat 6 - 9 nëntor 2024

8 kompani pjesëmarrëse: 3 kompani të artizanatit, 4 kompani pije dhe ushqim; 1 kompani konsulencë punësimi.

Nr.	Aktiviteti	2024
1	Pjesëmarrje në Panaire	7
1.1	Numri i Subjekteve pjesëmarrës në panaire	45
1.2	Numer kontratash potenciale nga panairot	210
2	Nr. Tryezave të rrumbullakëta të realizuara	4
2.1	Nr. Pjesëmarrësve në tryezat e rrumbullakëta	112
3	Numri i trajnimeve të zhvilluara	9
3.1	Numri i pjesëmarrësve në Trajnime	85
4	Numri i pyetësorëve të realizuar	3
4.1	Numri i subjekteve të anketuar	255

b) Performanca e produktit “Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” (shpenzime korente) dhe 4 (katër) projekteve të financimit: “Fondi i Inovacionit”, “Fondi i Konkureshmërisë”, “Fondi Start Up” dhe “Fondi i Ekonomisë Kreative” (shpenzimeve kapitale).

Indikatore:

a) Përgatitje të dokumentacionit për miratim të granteve 2024

AIDA ndermorri të gjithë hapat e nevojshëm për përgatitjen dhe miratimin e “Fondit për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024”. Pas miratimit nga të gjitha hallkat përkatëse, fondi u çel me 12 Korrik 2024 dhe qendroi i hapur për aplikime deri me 11 Gusht 2024.

Për vitin 2024, u miratua shuma 151,830,000 lekë

- Gjithsej 355 aplikime (142 aplikime refuzuar për mungesë dokumentacioni)
- 213 aplikime të vlerësuara nga bordi;
- 101 aplikime fituese nga të cilat:

- 54 fitues për shpenzime korrente

- 47 fitues për shpenzime kapitale (28 fitues - konkurrueshmëria, 6 fitues - inovacioni, 6 fitues - artizanati dhe 7 - start-upet).

b) Krijimi i leaflet promovues/informues për grantin + materiale të tjera për media

Broshura gjendet në këtë link [https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Fondet-2024_Web-1.pdf]

AIDA gjithashtu ka prodhuar dhe publikuar në mediat e saj sociale infografe me qëllim rritjen e vizibilitetit të skemës për mbeshtetje me grant.

c) Promovim i grantit nëpërmjet zhvillimit të ditëve informuese (5 ditë informuese në qarqet kryesore dhe 1 ditë informuese në zyrat e AIDA-s)

AIDA zhvilloi 5 sesione informuese me qëllim promovimin e grantit. Sesionet u zhvilluan në Shkodër, Fier, Korçë, si dhe dy sesione në Tiranë.

d) Përgatitja e raportit final të grantit mbi ecurinë, impaktin dhe problematikat e hasura.

AIDA ka përmbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme mbi ecurinë, impaktin, problemet e hasura si dhe monitorimin e projekteve përfituese të grantit. Aktualisht, shuma totale e disbursuar nga AIDA është në masën 149,370,354 lekë, nga plani i ndryshuar prej 150,030,000 lekë, ose 99.6%.

Përpos indikatoreve të parashikuar, Drejtoria NVM dhe Projekte realizoi gjithashtu edhe një video-dokumentar përmbledhës të të gjithë ecurisë së fondit, si dhe duke përfshirë një pjesë të projekteve të zbatuara nga përfituesit e fondit. Realizimi i videos ka për qëllim promovimin e skemës së granteve dhe ndërmarrjeve përfituese të cilat kanë zbatuar projekte me vlerë të shtuar në vendin tonë.

Fondet e AIDA-s	Viti 2024			% realizimit
	Vlera	Numri Aplikuesve	Numri Përfituesve	
Fondi i akorduar pas ndryshimeve	150,030,000	355	101	100%
Skema 1 Shpenzime Korrente	98,200,000	162	54	100%
Skema 2 Shpenzime Kapitale	51,830,000	193	47	100%
Konkurrueshmëri	35,830,000	110	28	
Inovacion	5,600,000	41	6	
Artizanat	4,800,000	14	6	
Start up	5,600,000	28	7	

Muaji i Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme

Në kuadër të përmbushjes së objektivave për rritjen e aftësive konkurruese dhe inovative të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme, nxitjen dhe promovimin e eksporteve, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), gjatë muajit prill 2024, si muaji i dedikuar NMV-ve shqiptare, në ambjentet e saj, organizoi 3 tryeza të rumbullakta me qëllim identifikimin e nevojave të kompanive të sektorëve si: “Verë”, “Lëkurë Këpucë” dhe “Vaj Ulliri, Mjalt, Prodhime të Përpunimit të Qumështit”.

Zhvillimi i këtyre tryezave kishte në fokus nxitjen, përfshirjen e aktorëve dhe përfaqësuesve të bizneseve të këtyre sektorëve për identifikimin e nevojave, problematikave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve dhe adresimin e rekomandimeve pranë institucioneve përkatëse.

- Tryezë e rumbullakët “Sfidat dhe identifikimi i nevojave të sektorit të Verës”, zhvilluar më datë 19 prill 2024.
- Tryezë e rumbullakët “Sfidat dhe identifikimi i nevojave të sektorit “Lëkurë – Këpucë”, zhvilluar më datë 23 prill 2024.
- Tryezë e rumbullakët me prodhuesit “Made in Albania”, të sektorit të Vajit të Ullirit, Mjaltit dhe Produkteve të Përpunimit të Qumështit, zhvilluar më datë 30 prill 2024.
- Panairi “Ditet e Bujqësisë”, në datat 24-26 prill 2024, Lushnje.
- Eventi “Zgjidh te Vendit”, AIDA, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, organizoi në datën 23 maj eventin "Zgjidh të Vendit". Krahas promovimit, ky event synon të rrisë ndjeshmërinë tek Hotelëritë dhe Restorantet vendase për të përfshirë në menutë e tyre produktet vendase.

c) Përformanca e projektit “Përmirësim sistemesh”, nga zëri shpenzime kapitale (Ilogaria 231).

Fondi në dispozicion prej 2,000,000 lekë për projektin “Përmirësim sistemesh”, nuk ka mundur të hidhet për prokurim publik në vitin 2024 pasi ky zë lidhet me mirëmbajtjen e sistemit të Regjistrimit të Investimeve Strategjike, i cili nuk u finalizua vitin e kaluar. Ndaj me shkresën tone nr. 868 prot., datë 24.06.2024 “Kërkesë për ndryshim destinacioni të fondit të akorduar për projektin me financim të brendshëm ‘Përmirësim sistemesh’, pjesë e programit ekonomik “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, kemi kërkuar ndryshim destinacioni të këtij fondi. Konkretisht u kërkuua alokimi i fondit prej 2,000,000 lekë për projektin “Blerje pajisje elektronike AIDA”. Kjo kërkesë erdhi në kuadër të riskstrukturimit të AIDA-s, proces i cili pritet të shoqërohet me shtesë stafi me rreth 12 punonjës të rinj. Kërkesa jonë u miratua nga MEKI dhe me shkresën e MF me nr. 10001/1 prot., datë 08.08.2024, fondit ju ndryshua destinacioni. Në vijim me shkresën tonë me nr.1393/2 prot., datë 16.08.2024 drejtuar AKSHI-t, kemi kërkuar ndjekjen e procedurës të prokurimit të fondit prej 1,666,666 lekë pa TVSH sipas sasive dhe specifikimeve të kërkuara nga AIDA. Në përfundim të procedurës të ndjekur nga AKSH-i u lidh kontrata me 2(dy) operator ekonomik për furnizimin me 10 PC dhe 4 UPS. Fondi i mbetur papërdorur nga procedura e ndjekur nga AKSH u rihodh për prokurim nga AIDA por për shkak se OE të klasifikuar nga sistemi APP si potencial u tërhoqën, duke mos lënë afat kohor të mundshëm për rihedhjen e tenderit, ndaj dhe procedura dështoi.

d) Përformanca e projektit me financim të huaj “Skills for jobs Albania Montenegro” dhe projekti “TVSH për projekte me financim të huaj” nga zëri shpenzime kapitale (Ilogaria 231).

✓ **Projektet me financim të huaj.**

Përsa i përket projekteve me financim të huaj për vitin 2024, sqarojmë si më poshtë:

- Në lidhje me projektin me financim të huaj me emërtim “Skills for jobs Albania - Montenegro” në buxhetin e AIDA-s për vitin 2024 u parashikuar dhe rishikua financimi i huaj prej 3,800,000 lekë. Ndërkohë fondet e disbursuara nga donator për këtë projekt për periudhën raportuese në masën 2,430,031.75 lekë dhe të shpenzuara janë 3,793,163 lekë. Sipas Udhëzimit nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, AIDA ka kryer raportimin e ecurisë së këtij projekti në MEKI dhe MF duke respektuar afatet e përcaktuara.

✓ **TVSH për projekte me financim të huaj**

Në zbatim të aktiviteteve në kuadër të implementimit të projektit me financim të huaj “Skills for jobs Albania Montenegro”, gjatë periudhës raportuese është kompensuar nga projekti “TVSH për projekte me financim të huaj” detyrimi lindur për pagesë fature me vlerë të TVSH-s në masën 4,667 lekë, pra nga plani i rishikuar për këtë zë prej 400,000 lekë, realizimi ishte i ulët nga fakti se

Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

aktivitetet reeferuar projektit me financim të huaj në fjalë nuk gjeneruar fatura me TVSH për të sjellë nevojë për kompensim nga ky fond.

3. Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

Objekti i veprimtarisë të AIDA-s, në buxhetin e akorduar për vitin 2024, konkretisht produkti jo projekt “Grante për mbështetjen e bizneseve” dhe në produktet të ndarë në 4(katër) projekte, ka parashikuar trajtime me bazë gjinore. Në përfundim të procesit të shpërndarjes tërësore të granteve të akorduara për vitin 2024, nga analiza e kryer nga Drejtoria e Projekteve, NVM dhe Eksporteve, rezulton se nga 101 përfitues të dy skemave të mbështetjes me grante për vitin 2024, 41 prej tyre kanë drejtuese femër.

Ndërkohë pjesa tjetër e aktiviteteve që zhvillon AIDA në rolin e promovueses të Shqipërisë si destinacion për investime, lidhet me targetimin dhe asistencën që ofrohet për investitorët vendas dhe të huaj, praktikë e cila nuk bën diferencim me bazë gjinore.

4. Performanca e buxhetit në nivel programi - AIDA

- REALIZIMI I SHPENZIMEVE KORENTE DHE KAPITALE SIPAS TAVANEVE BUXHETORE PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2024

Në lekë

Artikulli	EMËRTIMI	VLERA NË FILLIM TË VITIT NË BUXHET	VLERAT PAS NDRYSHIMEVE	FAKTI I REALIZIMIT TË BUXHETIT		FAKTI SHPENZIME THESAR JANAR – DHJETOR (I+II)	PËRQINDJA E REALIZIMIT (%)
				JANAR – MARS (I)	PRILL - DHJETOR (II)		
600	Paga	53,186,000	44,186,000	11,007,498	33,039,094	44,046,592	100
601	Sigurime Shoqërore	12,124,000	7,224,000	1,798,363	5,414,616	7,212,979	100
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	34,502,000	45,502,000	5,231,275	39,664,705	44,895,980	99
604	Grante për mbështetje në bizneseve	100,000,000	98,200,000	0	97,775,507	97,775,507	100
606	Transferta për Buxhetet Familjare & Individ	48,000	81,300	0	77,300	77,300	95
A. Total 600-606		199,860,000	195,193,300	18,037,136	175,971,222	194,008,358	99

Rruga “Skërdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

230	Shpenzime për rritjen e aktiveve qendrore të patrupëzuar a	51,830,000	0	0	0	0	0
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve qendrore të trupëzuara (Buxheti Shtetit)	5,170,000	54,230,000	0	52,415,970	52,415,970	97
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve qendrore të trupëzuara (Financim i huaj)	8,300,000	3,800,000	1,093,828	2,699,335	3,793,163	100
B. Total 230-231		65,300,000	58,030,000	1,093,828	55,115,305	56,209,133	97
TOTAL (A+B)		265,160,000	253,223,300	19,130,964	231,086,527	250,217,491	99
Kapitulli 6		5,230,362	9,347,967	0	621,152	621,152	

Sqarim: Lidhur me financimin e huaj rezulton një mos përputhje midis realizimit të fondit si periudhë raportuese dhe realizimit të fondit në nivel grupi. Konkretisht, fondi prej 1,093,828 lekë ë është shpenzuar faktikisht gjatë periudhës janar – mars 2024 (sikurse është shënuar dhe në tabelën e mësipërme) por është njohur si realizim në grupin 12 pas muajit mars 2024, pasi në momentin që AIDA kaloi në grupin 12 ky projekt u lidh me kod projekti dhe nisi raportimi faktik që u pasqyrua dhe në tabelat e buxhetit. Ndaj në Anekset e realizimit të buxhetit e gjithë vlera vjetore e realizuar nga financimi huaj është në raportimet e AIDA-s për grupin 12.

Gjatë periudhës raportuese, ecuria (performanca) e realizimit të shpenzimeve korente dhe kapitale sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas burimeve të financimit, ka patur këtë rezultat:

- **Shpenzime për paga (artikulli 600):** është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 100% të fondit të rishikuar për vitin 2024.
- **Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore (artikulli 601):** është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 100% të fondit të rishikuar për vitin 2024.
- **Shpenzime për mallra dhe Shërbime të Tjera (artikulli 602):** është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 99% të fondit të rishikuar për vitin 2024. Përpos nevojave

dhe prokurimeve përkatëse, në këtë zë janë realizuar shpenzimet për pjesëmarrje në konferenca dhe panaire, realizimin e aktiviteteve dhe të tjera në përputhje me veprimtarinë dhe fokusin e agjencisë.

- **Grante për mbështetje të bizneseve (artikulli 604):** është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 100% të fondit të rishikuar për vitin 2024.
- **Transferta për Buxhetet Familjare & Individ (artikulli 606):** është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 95% të fondit të rishikuar për vitin 2024.
- **Shpenzimet kapitale në artikullin 231:**
 - I. **Me financim të brendshëm:** Fondet e parashikuara për këtë artikull janë të ndara në:
 - *4 (katër) projektet e financimit* për mbështetjen e NMVM-ve për projekte kapitale për mbështetjen me grante për fuqizimin e NVMV-ve. Fondet e parashikuara nga fillimi vitit 2024 për këto projekte është realizuar në masën 100%.
 - *Investimin e brendshëm në masën 2,000,000 lekë*, e cila u kanalizua gjatë muajit gusht 2024 për zërin “Blejje pajisje elektronike AIDA” për shkaqe të shpjeguara dhe më lartë është realizuar në masën 41%.
 - II. **Me financim të huaj për projektet:**
 - Me emërtim “Skills for jobs Albania - Montenegro” në buxhetin e rishikuar të AIDA-s për vitin 2024 u parashikuar financimi i huaj prej 3,800,000 lekë. Deri në fund të periudhës raportuese realizimi i këtij zëri është në masën 100%.
 - Për këtë projekt AIDA ka shpenzuar si bashkëfinancim shumë prej 4,667 lekë për rimbursim TVSH, ose 1% të fondeve të rishikuara për këtë zë.

- **REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2024**

Në zbatim të ligjit nr 55/2015 "Per investimet strategjike ne Republiken e Shqiperise" dhe VKM nr. 1027, date 16.12.2015 "Per tarifat e sherbimeve per investimet strategjike" përfiton të ardhura nga shërbimet e asistencës së kryera pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për aplikimet për investitor strategjik. Referuar këtyre tarifave, Agjencia për 12-mujorin e vitit 2024, për shërbimet e kryera ka përfituar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit nga shoqëritë aplikuese për investitor strategjik tarifa në vlerën totale prej **1,445,000 lekë**.

Ndërkohë gjatë kësaj periudhe raportimi AIDA ka përfituar të ardhura jashtë limit për tu përdorur nga institucioni nga dy burime:

a. Ragonal Cooperation Council (RCC) në bazë të akt marrëveshjes me nr. 510/1 prot., datë 03.04.2024, në kuadër të “*Fushatën informuese për tërheqjen e investimeve të huaja direkte të qëndrueshme (IHD), duke çuar në rritjen e aktivitetit ekonomik, shkëmbimin e njohurive teknologjike dhe ndikime pozitive rajonale, me qëllimin përfundimtar të krijimit të vendeve të punës dhe përmirësimit të mirëqenies në Ballkanin Perëndimor*”, gjatë periudhës raportuese është akorduar fondi prej **575,400 lekë**, ndërkohë shpenzimet e kryera referuar marrëveshjes janë kryer në masën **621,152 lekë**, (6,000 euro + 21,819 lekë gjendje nga marrëveshja e vitit 2023 me RCC).

Fondet e shfrytëzuara mbi vlerën e grantit të vënë në dispozicion nga RCC janë nga fondi i AIDA-s në kapitullin 6, nga tepricat e granteve kapitale të mbetura nga projektet e kaluara (të mbyllura) me financim të huaj. Ndërkohë rezulton se nga dega e thesarit (sektori i të ardhurave) është kryer

Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

një rritje e autorizuar e të ardhurave të parashikuara për tu derdhur në buxhet në të ardhura dytësore për AIDA-n në masën 194,600 lekë. Pritet kryerja e sistemimit vitin e ardhshëm.

b. Projekti me financim të huaj “EEN Albania” në mbyllje të implementimit të tij, në llogarinë e bankës së nivelit të dytë ku administroheshin fondet nga ky projekt, rezultonte një gjendje kreditore prej 3,608,616.8 lekë. AIDA me shkresën nr. 867 prot., datë 24.06.2024, drejtuar Ministrisë së Financave parashitroi nevojën për akordimin e këtyre fondeve si të ardhura për institucionin, për tu përdorur për shpenzime korente nga kapitulli 6. Aktualisht në gjendjen e llogarisë të AIDA-s të kapitullit 6 është shtuar vlera prej 3,542,205 lekë. Por fondet që priten të trashëgohen në vitin 2025 në kapitullin 6 janë në masën **8,726,815 lekë**.

Total shtesa në kapitullin 6 gjatë periudhës raportuese është në masën **4,117,605 lekë**.

5. Performanca jo - financiare e programit buxhetor - AIDA

Nga analiza sasiore e realizimit të objektivit në nivel produkti, për disa tregues AIDA ka arritur nivelet e pritshme.

Më poshtë po ju paraqësim analizën e performancës të produktit jo – projekt “*Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit*”, në nivel treguesish.

- Mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë (IS);

Gjatë periudhës raportuese realizimi i treguesevë të performancës krahasuar me planin për këtë objektiv janë në një mesatare prej 40%. Ky realizim është në këto norma pasi deri në muajin prill 2024, ligji nr. 55/2015 ‘Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë’, ishte me afat të përfunduar për aplikimet për statusin e Investitorit Strategjik, ndaj gjatë periudhës janar – prill 2024, AIDA nuk ka pranuar aplikime të reja dhe as janë dhënë statuse të reja. Vetëm pas kësaj periudhe me shtyrjen e afatit të rishikimit të ligjit për investimet strategjike rinisën aplikimet e reja.

Theksojmë se gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Investimeve, specifikisht sektori i One Stop Shop ka punuar maksimalisht për ndjekjen e projekteve me status të miratuar dhe atyre në fazë asistimi. Gjithashtu aplikimet e reja janë ndjekur në çdo hap si nga shprehja e interesit deri në fazën përfundimtare të marrjes ose jo të statusit.

- Suportin e kompanive SME nëpërmjet fondeve;

Gjatë periudhës raportuese treguesit e performancës për këtë objektiv janë tej kaluar pritshmëritë, me rreth 41 aplikante femra të mbështetura me grante nga 101 aplikant të shpallur fitues nga fondet e vitit 2024

- Nxitjen e Investimeve të Huaja direkte (IHD)

Gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2024, referuar dhe indikatorëve tregues të zbatimit të këtyre objektivave, AIDA ka arritur një tej kalim të pritshmërive të këtyre indikatorëve.

Konkretisht gjatë vitit 2024, AIDA ka mbajtur rreth 163 takime after care, gjatë muajit maj 2024 me mbështetjen financiare të Racional Cooperation Council (RCC), ka realizuar një fushatë outreach në Madrid dhe Barcelon të Spanjës, ku nga 10 kompani të targetuara u mbajt takim me 4 prej tyre. Gjithashtu janë mbajtur takime në njësi bashkiake në qytete të ndryshme të Shqipërisë në kuader të fushatave after care.

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periudha e
Raportimit:
01.01.2024
deri
31.12.2024

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Objektivat e politikës:	Kodi i Programit	04130	Emerti mi i programit:	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik			Perqindja e realizimit per 12-mujorin
				**Treguesit e performancës/Produktet:			
					Plani 2024	FAKTI VITI 2024	
			Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit		12-mujori	
1	Mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë	Numri i aktiviteteteve promovuese	91205A E	Numri i aktiviteteteve promovuese	10	10	100%
		Nr i kompanive aplikuese per status	91205A E	Nr i kompanive aplikuese	35	14	40%
		Nr i kompanive përfituese te statusit	91205A E	Nr i kompanive përfituese	20	8	40%

2	Nxitja e Investimeve të Huaja direkte (IH D)	2.1	Numri i takimeve after care te organizuar a	91205A E	Numrii aktiviteteve te organizuar a	20	163	815%
		2.2	Zgjerimi i rrjetit dhe bashkepunimi me partnere	91205A E	Zgjerimi i rrjetit dhe bashkepunimi me partnere	2	4	200%
		2.3	Numri i kompanive dhe investitoreve te targetuar gjate fushata outreach	91205A E	Numri i kompanive dhe investitoreve te targetuar gjate fushata outreach	10	20	200%
3	Supportin e kompanive SME nëpërmjet fondëve	3.1	Numri i NVMV-ve te mbeshtetura me fonde publike	91205A B	Numer perfituesish	86	101	117%
		3.2	Numri i NVMV me drejtuese femer qe ka perfituar nga fondet publike	91205A B	Numer perfituesish	12	41	342%
		3.3	Numri i kompanive te asistuarane Panaire brenda dhe jashte vendit	91205A E	Numer perfituesish	30	41	137%

6.Përfundime dhe konkluzione

Në përfundim, AIDA gjatë vitit 2024 ka arritje të plotë të objektivave, si më poshtë:

- Finalizimin e procesit të ristrukturimit të AIDA-s, (miratimi i tij me Vendimit nr. 1, datë 08.11.2024 (nr.1749 prot., datë 08.11.2024) “Për disa ndryshime në vendimin nr. 3, datë 17.06.2019 të Bordit Drejtues “Për miratimin e niveleve të pagave dhe të organikës të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, të Bordit Drejtues),
- Finalizimin e procesit të shpërndarjes së fondeve të akorduar për mbështetje me grante të NVMV-ve nga projekte me fonde nga shpenzime korente dhe kapitale.
- Ka siguruar kushtet e nevojshme të infrastrukturës IT për pritjen e stafit të ri, me përjashtim të kushteve logjistike për akomodimin e tyre (mobilje zyre).
- Realizimin e një përqindje të kënaqshme të fondeve të akorduara për shpenzime korente dhe për investime publike brenda tavanëve buxhetore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR EKZEKUTIV

LAURA PLAKU (SARO)



Konceptoi: E.Ymerali

Kodi i Programit	Kodi i Grupit	Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Viti paraardhës 2023		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese			
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive grupi 10	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive grupi 12	Struktura e shpenzimeve në %	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive grupi 10	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive grupi 12		
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (6-3))	(8)	(9)	(10 (8/6))	(11 (8/6))			
EMËRTIME													
Shpenzimet sipas programeve buxhetore													
Emërtimi													
04130		78,748,486.00		265,223,300.00									
Mecanteje për Zhvillimin Ekonomik-Agjenca Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve													
Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01,02,03,04,05,06,22)		78,748,486.00		265,223,300.00									
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limiti (Kap 00)													
Totali Shpenzimeve të Ministrisë		78,877,667.00		265,223,300.00									
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik													
Emërtimi													
600	Paga	38,802,256.00		53,186,000.00									
601	Sigurime Shoqërore	5,932,037.00		12,124,000.00									
602	Mallë dhe Shërbime të Tjera	32,202,391.00		34,502,000.00									
603	Subvencione	0.00		0.00									
604	Transferata Korrente të Brendshme	0.00		100,000,000.00									
605	Transferata Korrente të Huaja	103,846.00		48,000.00									
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	0.00		0.00									
Non-Totali Shpenzime Korrente		77,101,133.00		195,163,300.00									
230	Kapitale të Patrupezuara	0.00		51,830,000.00									
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00		57,000,000.00									
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		0.00		108,830,000.00									
230	Kapitale të Patrupezuara	1,647,353.00		8,300,000.00									
231	Kapitale të Trupëzuara	1,647,353.00		8,300,000.00									
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj		3,294,706.00		16,600,000.00									
Totali Shpenzime Kapitale		1,647,353.00		8,300,000.00									
Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor		78,748,486.00		265,223,300.00									
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limiti (Kap 00)													
